




Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 1278/25

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Kimete Gashi Brajshori- Kryetare, Batisha Ibrahim - Anëtare si dhe Vedat Poterqoi- Anëtar, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Komuna Drenas me numër 1278/25, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE Korabi - Gllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rehabilitimi i rrugës dhe ndertimi i trotuarit Arllat-Negrovc dhe Vuqak, me nr: të prokurimit: 611-25-5498-5-1-1, iniciuar nga Komuna Drenas, më: 14.01.2026 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Komuna Drenas, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE N.N.T. Korabi - Gllogoc, me nr: unik 810248791, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rehabilitimi i rrugës dhe ndertimi i trotuarit Arllat-Negrovc dhe Vuqak, me nr: të prokurimit: 611-25-5498-5-1-1, me nr: të prokurimit: 622-24-8069-2-2-1, iniciuar nga Komuna Drenas.

ARSYETIM

Kërkesa e AK- Komuna Drenas:

1. Autoriteti kontraktues pretendon se OE Korabi, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Rehabilitimi i rrugës dhe ndertimi i trotuarit Arllat-Negrovc dhe Vuqak, me nr: te prokurimit: 611-25-5498-5-1-1, ka mashtruar me deshmit e dorezuara për Inxh. Vehbi Goxhuli.
2. Autoriteti kontraktues, përmes kërkesës së datës: 11.09.2025, ka sqaruar se Inxhinieri Vehbi Goxhuli përmes email-it (pa kërkesë të autoritetit kontraktues) ka deklaruar se me OE Korabi kam pasur marrëveshje për një projekt në vitin 2024 dhe se kjo marrëveshje ka përfunduar dhe nuk kam tjetër marrëveshje me OE Korabi. Në vazhdim inxhinieri i lartpërmendur, ka deklaruar se nuk i kam dhënë asnjë autorizim OE Korabi që të përdoren dokumentet e mia dhe në fund inxhinieri deklaroi se nënshkrimi im është falsifikuar.
3. Inxhinieri Vehbi Goxhuli, me tutje në email-in e tij dërguar AK-së, deklaroi se kompania në fjalë ka nisur të më kontaktojë me qëllim të ushtrimit të presionit dhe frikësimit duke më kërkuar që të jap deklaratë të rreme, kinse kam marrëveshje me të re me kompaninë Korabi.
4. Inxhinieri Vehbi Goxhuli, ka dërguar email edhe në OSHP, me të njëjtat sqarime për keqpërdorim të dokumentacionit të tij.

Mbi bazën e sqarimeve të dhëna më lartë, autoriteti kontraktues kërkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 të LPP-së me pretendimin se OE Korabi, ka paraqitur dokumente me përmbajtje të rreme ose të falsifikuara.

Kërkesa e OSHP-së drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 11.09.2025, te AK - Komuna Drenas, e ka njoftuar OE Korabi, me qellim qe operatori ekonomik ne fjale te jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE Korabi, në përgjigje te kërkesës se OSHP-se, me daten: 15.09.2025, ka dhene faktet dhe argumentet e veta lidhur me pretendimet e AK-se duke e kundërshtuar ne teresi pretendimin e AK-se dhe nder te tjera ka deklaruar se një ndër faktet më të rëndësishme të cilin ky inxhinier nuk e shpërfaqë, por që vërtetohet nga Kontrata e Punës, është fakti se kontrata efektin e saj e fillon me datë 17.5.2024 dhe është kontratë në kohë të pacaktuar, që dëshmohet me Nenin 3 të saj, ku thuhet se: “marrëveshja e kontratës mbi vepër nga data 17.5.2024 deri në kohë të pacaktuar, pra palët kontraktuese u pajtuan që të lidhin marrëveshje në kohë të pacaktuar”. Sipas OE Korabi i njëjti në deklaratat e tij nën betim thekson se kontrata e tij ka qenë vetëm për një projekt, mirëpo nga Kontrata e Punës rezulton se e njëjta është lidhur në kohëzgjatje të pacaktuar, që nënkupton se kontrata do të jetë valide deri në ndërprerje në mënyrë të njëanshme apo me marrëveshje nga Operatori Ekonomik dhe inxhinieri.

Me tutje, ne sqarimin e tij OE Korabi deklaroi se, një fakt shumë me rëndësi të cilin e ka fshehur si Autoriteti Kontraktues, ashtu edhe inxhinieri Vehbi Goxhuli, me qëllim që t’i shkaktojnë dëm të pariparueshëm Operatorit Ekonomik është fakti se inxhinieri i ka të paguara të gjitha kontributet pensionale si dhe pagat e tij përmes llogarisë bankare. Pra, inxhinieri është i deklaruar pranë Administratës Tatimore të Kosovës si punëmarrës me punë sekondare, kurse pagat i paguhen përmes llogarisë bankare, por që thekson se kontrata e tij është falsifikuar. Pyetja më e rëndësishme në këtë rast është, pse Inxhinieri nuk i ka kthyer të hollat në llogarinë e Operatorit Ekonomik, meqë nuk kanë pasur një marrëdhënie kontraktuale, si pasojë e asaj që po Faqe 5 nga 7 pretendohet nga inxhinieri se është pasurim i pabazë. Përgjigjja e kësaj pyetjeje është shumë e thjeshtë dhe e qartë: inxhinieri nuk e ka informuar fare punëdhënësin primar, operatorin ekonomik Ndërtimi Ing Sh.P.K., se është i punësuar në një punë sekondare. Po ashtu, arsyeja tjetër është se ofertues në aktivitetin e njëjtë të prokurimit është operatori ekonomik World Medium Sh.P.K., me aksionar Burim Zabelaj, kurse inxhinieri Goxhuli si punëdhënës primar sipas Kontratës së Punës ka të regjistruar operatorin Ndërtimi Ing Sh.P.K., me aksionar Shpejtim Zabelaj.

Sipas OE Korabi, inxhinieri Vehbi Goxhuli ka mashtruar nëpërmjet deklaratave nën betim, dëshmohet edhe me e-mailat e tij në vazhdim ku, ndër të tjera, në muajin Prill 2025, i ka dërguar Operatorit Ekonomik diplomën e tij të studimeve, kurse në e-mailat tjerë, diskutojnë lidhur me disa projekte të tjera në të cilat inxhinieri Goxhuli do të ishte i përfshirë – e që dëshmon të kundërtën e asaj që i njëjti ka qenë i angazhuar vetëm me një projekt dhe nuk ka bashkëpunuar më me Operatorin Ekonomik.

Ne fund te sqarimit te tij OE Korabi, si prove ka dorezuar:

1. Listen e ATK-se, deshmi se i jan paguar kontributet deri ne muajin 01.08.2025.

2. Pasqyren e llogarise bankare, me te cilen dehmon se e ka paguar inxhinierin deri me: 01.09.2025.
3. Email-in e dates: 24.04.2025.

From: **Vehbi Goxhuli** <vehbigoxhuli@yahoo.com>

Date: Thu, Apr 24, 2025 at 3:06AM

Subject:

To: **AVDULLAH MORINA** <nntkorabi@gmail.com>

Cc: nntkorabi@gmail.com <nntkorabi@gmail.com>,

SQARIM SHTESE:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pasi ka pranuar pergjigjet e paleve ne procedure dhe pas analzimit te deklarave te paleve, ka vleresuar se eshte e nevojshme te kerkohen sqarime shtese nga inxhinieri V. Goxhuli, per faktin se sipas deshmive, konkretisht sipas kontrates se punes, nenit 3 te kesaj kontrate, data e fillimit te punes se inxhinierit V.Goxhuli tek OE Korabi eshte 17.05.2024 deri ne kohe te pacaktuar. Arsye tjeter se pse i eshte kerkuar sqarim shtese inxhinierit ne fjale eshte edhe fakti se OE Korabi, sic u sqarua edhe me larte e ka dorezuar listen e pagave te leshuar nga NLB banka, ku figuron se inxhinieri ne fjal ka pranuar page deri ne muajin Shtator 2025.

Andaj, me daten: 19.11.2025, permes email-it, inxhinierit V. Goxhuli, i eshte kerkuar sqarim si ne vijim:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar nje kerkese per marrjen e masave sipas nenit 99.2 te LPP-se, me arsyetimin se OE Korabi ka perdorur pa autorizim dokumentet tuaja dhe lidhur me kete pretendim edhe ju keni reaguuar disa here per email-it, ku deklaroni se nenshkrimi juaj eshte falsifikuar dhe se keni pasur marreveshje vetem per vitin 2024 dhe sipas jush nuk keni pasur tjeter marreveshje me OE Korabi.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimi te kerkeses se autoritetit kontraktues, e ka njoftuar OE Korabi me qellim qe i njehti ti jep faktet dhe argumentet e veta dhe nder te tjera OE Korabi ka deklaruar se “kontrata ne mes OE Korabi dhe Inxh. Vehbi Goxhuli eshte nenshkruar me date: 17.05.2024 **deri ne kohë të pacaktuar**” dhe per kete deklarim OE Korabi e ka bashkangjitur edhe kontraten si prove, te cilen OSHP pas verifikimit ka rezultuar se eshte e njehta kontrate e dorezuar nga OE Korabi ne aktivitetin e prokurimit: Rehabilitimi I rruges dhe ndertimi I trotuarit Arllat-Negrovc dhe Vuqak.

Duke u bazuar ne provat e shqyrtuara deri me tani, konkretisht, kerkesen e autoritetit kontraktues, pergjigjen e OE Korabi dhe reagimet/sqarimet tuaja te dhena permes email-it, OSHP ka nevojte per disa sqarime shtese:

- A eshte kjo kontrata e vetme qe e keni nenshkruar me OE Korabi apo keni pasur tjeter kontrate..?
- Ne rast se eshte kjo kontrata e vetme qe keni pasur marreveshje me OE Korabi, a e keni nenshkruar ju..?

- A e keni njoftuar me shkrim OE Korabi per shkeputjen/nderprerjen e marredhenieve kontraktuale..?, sepse ne nenin 3 te kesaj kontrate thuhet se kontrata eshte valide prej: 17.05.2024 deri në kohë të pacaktuar.
-
- A keni pranuar page mujore sipas kontrates ne vitin 2025 nga OE Korabi..?

Si prove, ne email-in e dates: 19.11.2025, I jane bashkangjitur edhe lista e ATK-se, listat e pagesave te pages dhe kontrata e punes.

Ne pergjigjen e dates: 22.11.2025, inxh. V. Goxhuli, ka deklaruar:

Unë, Vehbi Goxhuli me numer personal:XXXXXX, deklaroj se në vitin 2024 kam nënshkruar një parakontratë me N.N.T. “Korabi”, e cila ka qenë e lidhur ekskluzivisht me projektin e ndërtimit të infrastrukturës së ulët në Komunën e Obiliqit. Parakontrata origjinale ka qenë e përbërë prej dy faqeve, ku faqja e dytë përmbante nënshkrimin tim, ndërsa faqja e parë ka pasur titullin e saktë të projektit për të cilin jemi dakorduar.

Deklaroj se dokumentin/parakontratën që N.N.T. “Korabi” paraqet aktualisht, nuk e njoh si dokument që unë e kam nënshkruar, pasi:

1. Faqja e parë e dokumentit të paraqitur nuk është e nënshkruar nga unë dhe përmbajtja e saj nuk përputhet me parakontratën origjinale të vitit 2024.
2. Në dokument vërehen ndryshime të bëra pa autorizimin tim, duke përfshirë pretendimin se kontrata është “në kohë të pacaktuar”, çka nuk ka qenë pjesë e marrëveshjes sonë.
3. Sipas vlerësimit tim, dokumenti i paraqitur është i falsifikuar ose i modifikuar në faqen e pare.

Sa i përket pagesave që N.N.T. “Korabi” pretendon se më ka kryer, deklaroj se ato kanë qenë të lidhura vetëm dhe ekskluzivisht me projektin e Obiliqit, projekt i shpallur fitues dhe i planifikuar të realizohej brenda dy viteve. Këto pagesa nuk lidhen me asnjë projekt tjetër, përfshirë projektin e Drenasit apo ndonjë projekt tjetër të prezantuar nga N.N.T. “Korabi”.

Gjithashtu, deklaroj se:

- N.N.T. “Korabi” nuk ka pasur autorizim nga ana ime që të përdorë dokumentacionin tim për projekte tjera.
- Çdo përdorim i dokumentacionit tim nga ana e tyre ka qenë i palejuar, i paautorizuar dhe i kundërligjshëm.
- Për projekte jashtë projektit të Obiliqit, operatori ekonomik ka qenë i detyruar të më kontaktojë, të kërkojë pëlqimin tim dhe të nënshkruajmë një kontratë të re – gjë që nuk ka ndodhur.

- Për këtë arsye, mbaj përgjegjësi vetëm për projektin e Obiliqit, ndërsa çdo veprim apo përdorim i dokumentacionit tim pa miratimin tim është i jashtëligjshëm dhe jashtë çdo marrëveshjeje.

Unë qëndroj plotësisht prapa deklaratës sime noteriale të dhënë në Autoritetin Kontraktues, e cila paraqet në mënyrë të saktë dhe të plotë qëndrimin tim në lidhje me këtë çështje.

Vlerësimi i pretendimeve të autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj OE Korabi:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, dhe arsyeshmërisë së dhënë, provave të ofruara nga OE Korabi, deklaratave të inxhinierit V.Goxhuli, diskutimeve dhe shoshitjes së provave paneli shqyrtues vlerëson se ka prova të pakontestueshme me të cilat deshmohet se OE Korabi, ka mashtruar apo falsifikuar me deshmit e dorezuara.

Paneli shqyrtues, merr paraysh faktin se OE Korabi poashtu ka dorezuar deshmi se komunikimi/bashkpunimi me inxhinierin në fjale ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025, sepse inxhinieri ka pranuar page mujore deri në muajin Shtator të këtij viti nga OE Korabi dhe të njëjtit i janë paguar edhe kontributet në ATK dhe njeherit OE Korabi ka bashkangjitur komunikimet elektronike që ka pasur me inxhinierin gjatë vitit 2025, ndërsa në anën tjetër inxhinieri deklaron se vetëm gjatë vitit 2024 kemi pasur bashkëpunim, duke qenë se edhe inxhinieri ka pranuar përfitime materiale nga kjo kontratë për të cilën tani po e konteston, paneli e vendos që OE të diskualifikohet vetëm për periudhën tre mujore nga data 14.01.2026 deri në 14.04.2026.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nënën 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Drenas

1x1 OE - Korabi - Glllogoc

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

